

Komisioni Shkollor për regjistrimin e nxënësve në vitin I (parë) të vitit shkollor 2024/2025 në SHMQSH Dimitar Vlahov-Shkup, bazuar në pikën 5 të Konkursit për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike për vitin shkollor 2024/2025 në Republikën e Maqedonisë së Veriut botuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pika 2 paragrafi 1 i paragrafit 2 të vendimit për themelimin e komisionit shkollor (nr. 02-602/1 të 01.04.2024), ndërsa lidhur me vendimin për publikimin e një konkursi të brendshëm për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë të afatit të qershorit (aplikimi i parë) në vitin shkollor 2024/2025 në Shkollën e Mesme të Shkupit "Dimitar Vlahov" Shkup (Nr. 02-680/1 prej 15.04.2024) njofton

KONKURS INTERN

për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë të afatit të regjistrimit qershorit (aplikimi i parë) në vitin shkollor 2024/2025 në Shkollën e Mesme të Qytetit të Shkupit "Dimitar Vlahov"- Shkup

Në vitin e parë, gjithsej 359 nxënës do të regjistrohen në 14 klasa (200 nxënës në 8 klasa me mësim në gjuhën maqedone, 134 nxënës në 5 klasa me mësim në gjuhën shqipe dhe 25 nxënës në 1 klasë me mësim në gjuhën turke) sipas planeve mësimore dhe programeve për:

DREJTIMI/SEKTORI: SHËRBIME PERSONALE - 259 NXËNËS, 10 KLASË

Profili arsimor/Kualifikimi	Gjuha mësimore	Numri i nxënësve	Numri i paraleleve	Kohëzgjatja e shkollimit	Numri minimal i pikëve
Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë *në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	25	1 paralele	katërvjeçar	45
Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë	Gjuhë shqipe	34	1 paralele	katërvjeçar	45
Floktar- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	75	3 paralele	trevjeçar	30
Floktar- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë shqipe	50	2 paralele	trevjeçar	30
Floktar- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë turke	25	1 paralele	trevjeçar	30
Estet për kujdesin e duarve dhe këmbëve * në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	25	1 paralele	trevjeçar	30
Estet për kujdesin e duarve dhe	Gjuhë shqipe	25	1 paralele	trevjeçar	30

këmbeve * në bashkëpunim me kompanitë					
--	--	--	--	--	--

Lëndët e arsimit fillor të parashikuara në kriteret për rangimin e suksesit të nxënësve janë:

- Lëndët mësimore të detyrueshme: gjuha amtare dhe gjuha e huaj;
- Lëndët mësimore që janë relevante për profesionin: biologjia dhe kimia.

DREJTIMI/SEKTORI I GRAFIKËS- 25 NXËNËS, 1 PARALELE

Profili arsimor/Kualifikimi	Gjuha mësimore	Numri i nxënësve	Numri i paraleleve	Kohëzgjatja e shkollimit	Minimum numri i pikëve
Editor-dizajner grafik-në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	25	1 paralele	katërvjeçare	45

Lëndët e arsimit fillor të parashikuara në kriteret për rangimin e suksesit të nxënësve janë:

- Lëndët mësimore të detyrueshme: gjuha amtare dhe gjuha e huaj;
- Lëndët mësimore që janë në kuptim me drejtimin janë: kimi dhe art figurativ.

DREJTIM/SEKORII KIMIKO-TEKNOLOGJIK, - 75 NXËNËS, 3 PARALELE

Profili arsimor/kualifikimi	Gjuha mësimore	Numri i nxënësve ци	Numri i paraleleve	Kohëzgjatja e shkollimit	Minimum numri i pikëve
Teknik i ushqimit- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	25 nxënës	1 paralele	katërvjeçare	45
Teknik i ushqimit- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë shqipe	25 nxënës	1 paralele	trevjeçare	45
Përpunues i mishit- në bashkëpunim me kompanitë	Gjuhë maqedonase	25 nxënës	1 paralele	trevjeçare	30

Lëndët mësimore prej arsimit fillor që janë parashikuar në kriteret për rangim të suksesit të nxënësve janë

- Lëndët obligative mësimore: gjuhë amtare dhe gjuhë e huaj
- Lëndët mësimore që janë të një rënësie për drejtimin: matematikë dhe kimi.

I. KUSHTET PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

Kushtet për regjistrimin e nxënësve në vitin I (parë) janë

- të kenë të përfunduar arsimin fillor;
- të mos jenë më të moshuar se 17 vjet;
- të jenë të përcaktuar për planin dhe programin e njërit prej drejtimeve/sectorëve që janë të përfaqësuar në shkollë;
- t'i plotësojnë kriteret e pohuara në konkurs;

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Pas shpalljes së listës për rangim, nxënësit duhet t'i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- **Fletëparaqitje për regjistrim** (fletëparaqitjen për regjistrim e lëshon Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe e publikon në web-faqen zyrtare);
- **Dëftesat origjinale prej klasës së VI deri më IX** ;
- **diploma**, (përderisa ka) për arritjen e vendit të (I, II, III) nga garat shtetërore dhe ndërkombëtare në gjuhën amtare, gjuhën e huaj, shkencat natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe lëndët mësimore që janë të rëndësishme të drejtimit/ sektorit përkatsisht fusha zgjedhore ;
- **Certifikatë e lindjes nga libri amë i të lindurve** (pa marrë parasysh datën e lëshimit).

III. AFATET E KONKURSIT

Paraqitja dhe regjistrimi i nxënësve do të realizohet në afatin regjistruar të qershorit në dy paraqitje.

Paraqitja e nxënësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik, përmes linkut të portalit për shërbime elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës <https://e-uslugi.mon.gov.mk> me lajmërim special për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive përdoruese personale në Schools.mk.

Paraqitja e parë elektronike e nxënësve do të realizohet më 20 qershor deri më 25 qershor të vitit 2024 deri me ora 15:00;.

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm deri tek shkolla bëhet më 20, 21, dhe 24 qershor nga ora 7.00 deri më ora 17:00 dhe më 25 qershor të vitit 2024 nga ora 7:00 deri më ora 15:00.

Lita përfundimtare e rangimit për secilën shkollë me rezultatet e regjistrimit dhe vendeve të lira do të shpallen më 26 qershor të vitit 2024, më së voni deri më ore 09.00 në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në faqen e internetit të shkollës.

Testimi i kualifikimit do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më 28 qershor të vitit 2024, ndërsa listat përfundimtare të rangimit me rezultatet do të shpallen më 28 qershor 2024 , në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe në faqen e internetit të shkollës.

IV. Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve

Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve janë:

- Suksesi mesatar i nxënësit nga klasa e VI deri në klasën e IX;
- Seksesi mesatar i nxënësit që ka arritur në katër lëndë (gjuhë amtare, gjuhë e huaj dhe sy lëndë që janë të rëndësishme të drejtimit/sektorit);
- Diploma për arritjen e vendeve të (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare, si dhe nga garat shtetërore (të organizuara prej shoqatave të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës) në gjuhën amtare, gjuhë të huaj, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe në lëndët mësimore që janë të rëndësishme të drejtimit/sektorit);
- Vlera mesatare nga pikët e fituara për sjelljen prej klasës VI deri në klasën e IX ..

Kryetar i komisionit të shkollës:

Jasminka Gudomanova

